

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Korçë

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË

“BERBER”

Kodi: B-19

Miratoi
DREJTOR

.....

Korçë, 2019

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“BERBER”

(B-19)

I. Profili profesional i berberit

a) *Karakteristikat e berberit*

Berberi është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në biznese që ofrojnë shërbime .

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, berberi duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë të mjedisit të berberit, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të berberit.

Suksesi i berberit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, përkujdesja, komunikimi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e berberit*

Profesioni i berberit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për lyerje, prerje, krehje, stilim dhe trajtim të flokëve si dhe këshillim të klientëve. Ai mund të punësohet në mjedise berberi dhe biznese apo veprimtari që kërkojnë shërbime berberi, si dhe mund të vetëpunësohen për të ofruar këto shërbime.

Një individ mund të ushtrojë profesionin e berberit fillimisht si ndihmës. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e berberit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës, një berber mund të ndërmarrë disa funksione mbikqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si menaxher i një salloni.

Për të zhvilluar aktivitetet privat në sektorin e berberit, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: berber, parukier për studio apo berber për skenë etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të kursit për berber

Në përfundim të kursit për berber, kursantët do të jenë të aftë të:

- përgatitin vendin e punës në sallon
- përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës
- përdorin dhe mirëmbajnë mjetet e punës
- kryejnë llogaritje ekonomike dhe veprime për pagesat
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike
- komunikojnë me etikë profesionale
- zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit
- hulumtojnë/ kërkojnë informacion në burime të ndryshme në formë fizike ose elektronike
- kryejnë larje të flokëve
- kryejnë prerje të flokëve
- lyejnë flokët me bojëra flokësh
- japin forma në përputhje me modelin e flokëve
- stilojnë flokët
- kryejnë trajtime të ndryshme të flokëve
- të analizojë llojin, gjendjen e fytyrës për trajtimet
- kryejnë trajtime të ndryshme të fytyrës
- kryejnë aplikimin e produkteve kozmetike të nevojshme për trajtimin e fytyrës

- regjistrojnë shërbimet e kryera
- kryejnë pastrimin e mjekrës sipas kërkesave të klientit
- kryejnë procedurën e larjes dhe tharjes së mjekrës
- kryejnë aplikimin e produkteve kozmetike të nevojshme për trajtimin e mjekrës
- ofrojnë këshilla për klientët
- presin klientin në vendin e punës

III. Kërkesat e pranimit në kursin për berber.

Pjesëmarrësit në kursin për “Berber“ duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e kursit për berber.

300 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e kursit për berber

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e berberit	B-01-19	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të berberit. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së berberit. 3. Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, komunikimit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në një sallon berberi. 4. Kursanti përshkruan llojet dhe karakteristikat e flokëve.
2	Prerja e flokëve	B-02-19	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e prerjes të flokëve. 2. Kursanti realizon larjen dhe trajtimin e flokut për prerje. 3. Kursanti realizon prerje të ndryshme. 4. Kursanti stilon flokët në varësi të prerjes.
3	Krehjet dhe stilimi i flokëve	B-03-19	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e krehjes dhe stilit të flokëve. 2. Kursanti realizon larjen dhe tharjen e flokut. 3. Kursanti stilon flokët në varësi të kërkesave të klientit.
4	Lyerja e flokëve	B-04-19	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e lyerjes së flokëve. 2. Kursanti realizon lyerjen e flokëve.

5	Trajtimi i fytyrës	B-05-19	40 orë mësimorë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimit të fytyrës. 2. Kursanti realizon trajtimin e fytyrës.
6	Modelimi i mjekrës	B--06 -19	70 orë mësimorë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e llojeve të mjekrës. 2. Kursanti realizon pastrimin e mjekrës me makinë. 3. Kursanti realizon rregullimin e mjekrës me krëhër dhe gërshërë. 4. Kursanti realizon pastrimin e mjekrës me bisturi, dyllë dhe me pe.

VI. Vlerësimi dhe certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e kursit për të gjitha rezultatet mësimore (RM-të) që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e moduleve të kursit për berber:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e berberit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E BERBERIT	B-01-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të berberit, me mjedisin dhe mjetet e punës së berberit, me rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me llojet dhe karakteristikat e flokëve të njeriut.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të berberit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e shërbimeve të berberit për individin;- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së berberit.- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së berberit;- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor berberi;- të përshkruajë proceset kryesore të veprimtarisë së berberit;- të tregojë organizimin e punës në një sallon berber;- të tregojë si organizohet grafiku i takimeve për shërbimet e berberit, në një sallon berberi;- të përshkruajë bazën e të dhënave të klientit;- të përshkruajë kërkesat profesionale për berberin;- të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të estetistit;- të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së një sallon berberi;- të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së berberit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë;- Pyetje përgjigje me shkrim.	
	RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së berberit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë mjedisin e punës në një sallon berberi;- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës së berberit;- të përshkruajë dhe të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së berberit;	

- të tregojë përdorimet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të punës së berberit;
- të mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së berberit
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e berberit.;
- të interpretojë etiketat dhe udhëzimet e prodhuesit për materialet e punës së berberit;
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së berberit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë;
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, komunikimit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në një sallon berberi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë veçoritë e tipeve të ndryshme të klientëve në një sallon berberi;
- të dallojë tipet e ndryshme të klientëve;
- përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me klientët, eprorët, kolegët etj;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës personale;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës së klientit, mjedisit dhe mjeteve të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e sigurisë së klientit dhe të mjedisit të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të berberit;
- të tregojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit të punës në një sallon berberi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti përshkruan llojet dhe karakteristikat e flokëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë ndërtimin e brendshëm të fijes së flokut;
- të përshkruajë anatominë e flokut dhe skalpit të kokës;
- të përshkruajë funksionet fiziologjike dhe estetike të flokut dhe skalpit të kokës;
- të përshkruajë karakteristikat e fijes së flokut si ngjyra, trashësia, forma, dendësia, gjatësia etj;
- të përshkruajë llojet e flokëve dhe karakteristikat e tyre;
- të dallojë llojet e flokëve;
- të përcaktojë llojin e flokut në bazë të përpunimeve kozmetike që i është nënshtruar më parë;
- të analizojë modelet tipike të flokëve dhe veçoritë e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së berberit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të berberit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në një sallon berberi. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e berberit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në një sallon berberi.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në një sallon berberi.
 - Manikinë parukerie
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Prerja e flokëve”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRERJA E FLOKËVE	B-02-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e dhe procedurat e prerjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes, prerjes dhe stilimit të flokëve të ndryshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e berberit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e prerjes së flokëve. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë që ka prerja e flokëve në një sallë berberi;- të përshkruajë procedurat kryesore për të realizuar prerjen e flokëve;- të tregojë mjetet për prerjen e flokëve dhe përdorimet e tyre;- të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të prerjes së flokëve;- të përshkruajë prerjet bazë të flokëve;- të analizojë faktorët që konsiderohen për të përzgjedhur llojin e prerjes së flokëve të klientit;- të analizojë llojet e fytyrave dhe të përshtatë prerjen e flokëve në varësi të tyre;- të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin;- të përshkruajë masat e higjienës për prerjen e flokëve. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Pyetje përgjigje me shkrim.	
	<p>RM 2 Kursanti realizon larjen dhe trajtimin e flokut për prerje. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">- të marrë informacion paraprak nga klienti;- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokut të klientit;- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për larjen dhe trajtimin e flokut për prerje;- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për larjen dhe trajtimin e flokut për prerje;- të përzgjedhë produktet e duhura në varësi të flokut;- të përcaktojë procedurat e larjes dhe trajtimit të flokut për prerje;- të realizojë larjen e flokut për prerje;- të bëjë trajtimin e flokut për prerje;- të komunikojë me etikë profesionale;- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p>	

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti realizon prerje të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për prerjen e flokut;
- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokut të klientit;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për prerjen e flokut;
- të përcaktojë llojin e prerjes së flokut, në bashkëpunim me klientin;
- të përcaktojë procedurat e prerjes së flokut;
- të realizojë ndarjen e flokut në seksione;
- të realizojë prerjen e drejtë ose 0 gradë;
- të realizojë prerjen e flokut 45 gradë;
- të realizojë prerjen e flokut uniformë;
- të realizojë prerjen e flokut me baluke;
- të realizojë prerjen e flokut me brisk dhe me makinë;
- të realizojë prerjen e flokut marins;
- të realizojë prerjen e flokut kapelon;
- të realizojë prerjen e flokut moikan;
- të realizojë prerjen e flokut me shkallëzim me gradë me makinë;
- të realizojë prerjen e flokut me krëhër dhe gërshërë;
- të realizojë prerjen e flokut kare agore (bisht kali);
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për prerjen e flokëve;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë.

RM 4 Kursanti stilon flokët në varësi të prerjes.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për stilimin e flokut sipas prerjes;
- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokut të klientit;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për stilimin e flokut;
- të përcaktojë stilin e flokut, në bashkëpunim me klientin;
- të përcaktojë procedurat e krehjes të flokut;
- të realizojë ndarjen e flokut në seksione;
- të realizojë krehje të ndryshme në varësi të llojit të prerjes;
- të tregojë produktet ndihmëse për stilimin e krehjes;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet e punës;
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm për flokët; - të komunikojë me etikë profesionale;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së berberit. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të berberit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në një mjedis berberi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për larjen, trajtimin për prerje, prerjen dhe stilimin e flokut, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjediset reale të punës në një sallon berberi.
 - Kompletet e materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për larjen, trajtimin dhe prerjen e flokut në një sallon berberi.
 - Mjete dhe pajisje prerëse të flokut.
 - Manikinë të ndryshëm.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesat, materialet të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Krehjet dhe stilimi i flokëve”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KREHJET DHE STILIMI I FLOKËVE	B-03-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e dhe procedurat e krehjes dhe stilimit të flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes, tharjes, krehjes dhe stilimit të flokëve.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e berberit” dhe “Prerja e flokëve,,.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e krehjes dhe stilimit të flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të tregojë mjetet për krehjen dhe stilimin e flokëve dhe përdorimet e tyre; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të krehjes dhe të stilimit të flokëve; - të analizojë faktorët që konsiderohen për të përzgjedhur llojin e krehjes dhe të stilimit të flokëve të klientit; - të analizojë llojet e fytyrave dhe të përshtatë krehjen dhe stilimin e flokëve në varësi të tyre; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin; - të përshkruajë masat e higjienës për krehjen dhe stilimin e flokëve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje përgjigje me gojë. <p>RM 2 Kursanti realizon larjen dhe tharjen e flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të analizojë llojin dhe gjendjen e flokut të klientit; - të përzgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për larjen dhe tharjen e flokut; - të përgatitë dhe pozicionojë klientin për larjen dhe tharjen e flokut; - të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për larjen dhe tharjen e flokëve; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli - Pyetje përgjigje me gojë. 	

RM 3 Kursanti stilon flokët në varësi të kërkesave të klientit

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të marrë informacion paraprak nga klienti
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokut të klientit;
- të përcaktojë modelin e krehjes, në bashkëpunim me klientin;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për krehjen e flokut;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për krehjen e flokut;
- të përcaktojë procedurat e krehjes së flokut;
- të realizojë ndarjen e seksioneve;
- të realizojë krehje në varësi të modelit;
- të realizojë krehje sipas llojit të fytyrës dhe formës së kokës;
- të realizojë krehjen e flokëve me difuzor;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për krehjen e flokëve;
- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.
-

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së berberit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të berberit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së berberit. Atyre duhet t'i jepen detyra praktike për larjen, tharjen, krehjen, stilimin dhe fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedisë reale të punës në një sallon berberi.

- Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për larjen, tharjen, krehjen dhe stilimin e flokut në një sallon berberi.
 - Mjete dhe pajisje larëse, tharëse, krehëse, stiluese.
 - Manikinë të ndryshëm.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Lyerja e flokëve”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	LYERJA E FLOKËVE	B-04-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e lyerjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e lyerjes së flokëve të ndryshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e berberit”, “Prerja e flokëve”, dhe “Krehjet dhe stilimi i flokëve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e lyerjes së flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë qëllimin, rëndësinë dhe historikun e lyerjes së flokëve në një sallë berberi;- të përshkruajë procedurat dhe rregullat kryesore për të realizuar lyerjen e flokëve;- të tregojë mjetet dhe pajisjet për lyerjen e flokëve dhe përdorimet e tyre;- të tregojë bojërat, materialet dhe produktet për lyerjen e flokëve, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;- të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të lyerjes së flokëve;- të analizojë faktorët që konsiderohen për të përzgjedhur llojin e lyerjes së flokëve të klientit;- të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin;- të përshkruajë masat e higjienës dhe të sigurisë për realizimin e lyerjes së flokëve. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Pyetje përgjigje me gojë RM 2 Kursanti realizon lyerjen e flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të marrë informacion paraprak nga klienti;- të analizojë llojin, gjendjen dhe lyerjet e mëparshme të flokut të klientit;- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për lyerjen e flokut.- të kryejë testin e alergjisë nga boja;- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për lyerjen e flokut;- të përzgjedhë bojrat dhe produktet e duhura në varësi të llojit dhe ngjyrës së lyerjes së flokut;- të përcaktojë procedurat e lyerjes së flokut;- të përcaktojë oksikremin që do përdorë;- të bëjë parapërgatitjen e flokut për lyerje;	

- të realizojë çeljen me fije, me kapuç, të flokëve;
- të trajtojë flokët me maska dhe ampula;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e lyerjes së flokut në vijimësi;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për lyerjen e flokut;
- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin.
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së berberit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të berberit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së berberit. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për lyerjen, dekolorimin, ngjyrosjen me fije të flokëve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në një sallon berberi.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës lyerjen, dekolorimin.
 - Mjete dhe pajisje larëse, tharëse dhe ngjyrosëse të flokut.
 - Manikinë të ndryshëm.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Trajtimi i fytyrës”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli	TRAJTIMI FYTYRËS	B-05-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e trajtimit të fytyrës, si dhe i aftëson ata që të kryejnë trajtimin e fytyrës.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrtje në profesionin e berberit”, “Prejja e flokëve,,,” “Krehjet dhe stilimi i flokëve” dhe “Lyerja e flokëve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimit të fytyrës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë qëllimin, rëndësinë dhe historikun e lyerjes së flokëve në një sallë berberi;- të përshkruajë procedurat dhe rregullat kryesore për të realizuar trajtimin e fytyrës;- të tregojë mjetet dhe pajisjet për trajtimin e fytyrës dhe përdorimet e tyre;- të analizojë faktorët që konsiderohen për të përzgjedhur llojin e trajtimit të fytyrës të klientit;- të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin;- të përshkruajë masat e higjienës dhe të sigurisë për realizimin e trajtimit të fytyrës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Pyetje përgjigje me gojë <p>RM 2 Kursanti realizon trajtimin e fytyrës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">- të marrë informacion paraprak nga klienti;- të analizojë llojin, gjendjen e fytyrës për trajtimet e mëparshme;- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për trajtimin e fytyrës;- të realizojë trajtimin e fytyrës me aparat e tampon;- të realizojë trajtimin e fytyrës me qumësht duke e masazhuar;- të realizojë trajtimin e fytyrës me tonik e tampon;- të kryejë aplikimin e maskës në varësi të lëkurës;- të kryejë aplikimin e kremi përkatës;- të përshkruajë trajtimin e duhur në kushte shtëpie;- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin;- të komunikojë me etikë profesionale;- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.	

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së berberit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të berberit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në një mjedis berberi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për trajtimin e fytyrës dhe trukimin e saj, fillimisht të mbikqyruar dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës së berberit.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për trajtimin e fytyrës.
 - Mjete dhe pajisje pastrimi.
 - Manikinë të ndryshëm.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Modelimi i mjekrës”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MODELIMI I MJEKRËS	B-06-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e modelimit të mjekrës, si dhe i aftëson ata që të kryejnë stilime të ndryshme mjekrash.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyryje në profesionin e berberit”, “Prerja e flokëve,, “Krehjet dhe stilimi i flokëve”, “Lyerja e flokëve”, “Trajtimi i fytyrës”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e llojeve të mjekrës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë dhe egzaminojë formën e fytyrës për pastrimin dhe modelimin e mjekrës;- të marrë informacion paraprak nga klienti;- të përshkruajë procedurat kryesore për të realizuar modelime të ndryshme mjekrash;- të tregojë mjetet, pajisjet dhe përdorimet e tyre.- të tregojë llojet e ndryshme të mjekrës;- të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin;- të përshkruajë masat e higjienës dhe të sigurisë për realizimin e modelimit të mjekrës. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Pyetje përgjigje me gojë RM 2 Kursanti realizon pastrimin e mjekrës me makinë. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të marrë informacion paraprak nga klienti;- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për pastrimin e mjekrës me makinë;- përgatisë dhe pozicionojë klientin për modelimin e mjekrës me makinë;- të realizojë pastrimin e mjekrës me makinë;- të realizojë procedurën e larjes, thatjes dhe krehjes së mjekrës në varësi të modelit;- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e mjekrës në vijimësi;- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për pastrimin e mjekrës;- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin;- të komunikojë me etikë profesionale;<ul style="list-style-type: none">- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 3 Kursanti realizon rregullimin e mjekrës me krëhër me gërshërë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për pastrimin e mjekrës me krëhër dhe gërshërë;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për modelimin e mjekrës me krëhër dhe gërshërë;
- të realizojë pastrimin e mjekrës me krëhër dhe gërshërë;
- të realizojë procedurën e larjes, tharjes dhe krehjes së mjekrës në varësi të modelit;
- të realizojë procedurën e tharjes së mjekrës;
- të realizojë procedurën e krehjes në varësi të modelit;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e mjekrës në vijimësi;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për pastrimin e mjekrës;
- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti realizon rregullimin e mjekrës me bisturi, dyllë dhe me pe.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për pastrimin dhe rregullimin e mjekrës me bisturi, dyllë dhe pe;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për pastrimin dhe rregullimin e mjekrës me bisturi, dyllë dhe pe;
- të realizojë rregullimin e mjekrës me bisturi;
- të realizojë rregullimin e mjekrës me dyllë dhe pe;
- të realizojë rregullimin e mjekrës me pe;
- të realizojë pastrimin e mjekrës total me bisturi;
- të realizojë procedurën e larjes dhe tharjes së mjekrës;
- të realizojë procedurën e tharjes së mjekrës;
- të trajtojë fytyrën me kremërat përkatëse;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e mjekrës në vijimësi;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për pastrimin e mjekrës;
- të bëjë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin.
- të komunikojë me etikë profesionale;

- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së berberit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të berberit. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në një mjedis berberi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike përpastrimin dhe rregullimin e mjekrës, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
--	--

Kushtet e domosdoshme për realizimin e Modullit	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në një sallon berberi. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të pastrimit dhe rregullimit të mjekrës. - Mjete dhe pajisje larëse, tharëse dhe prerëse të mjekrës. - Manikinë të ndryshëm. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
--	---
